



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 16, datë 07/02/2020

MBI

**“MIRATIMIN E PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS
NË “INTERPRETIM”, TË PARAQITUR NGA
DEPARTAMENTI I INTERPRETIMIT PRANË
FAKULTETIT TË MUZIKËS**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 79 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të MASR nr. 1, datë 14/01/2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”, VKM nr. 41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, (i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18/12/2019), pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga F.M., pasi i diskutoi me votim të hapur unanimisht,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të Doktoratës në **“Interpretim”**, të paraqitur nga Departamenti i Interpretimit pranë Fakultetit të Muzikës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim ti dërgohet për miratim paraprak Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve dhe më pas të përcillet në MASR për miratim përfundimtar, sipas Pikës 4, Kreut VI të Udhëzimit nr. 1, datë 14/01/2020 nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë Interpretim.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)